

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje pajisje speciale pune ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39300000-5 Pajisje të ndryshme

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 774 360 (nje milion e shtateqind e shtatedhjet e kater mije e treqind e gjashtedhjet) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. I ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 8, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e perllogaritur duhet të jetë jo më e vogël se 709 744 leke pa tvsh leke pa tvsh (40%) të vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë **arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4, "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së perllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave". Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Për rregullat e prokurimit publik", e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare të certifikuar nga organet tatimore (2022, 2023, 2024), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. Si dhe Ligjin nr 8438 dt 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar ,ku theksohet ”Cdo tatim pagues per gatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuara ne Udhëzimin e Ministrisë të Financave ne zbatim te ketij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.4Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 354 872 lek pa tvsh lek pa tvsh (20%) të vlerës së të vlerës së fondit të limit të kontratës

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Plotesimi i njerit prej dy kushteve e ben oferten te kualifikueshme

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda vlerës limit të kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e

rëndësishme, mbështetur në sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme

me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet objekt kontrate, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

2.2.6 Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 45001 ose ekuivalent dhe ISO 9001 ose ekuivalent për sistemin e menaxhimit të cilësisë, dhe të ofrojë certifikatën e vlefshme për përputhshmërinë e produktit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr 162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, ku parashikon që autoritetet kontraktore mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë kërkesat në lidhje me: “cilësinë, kapacitetin teknik, dhe profesional si dhe me standartet e menaxhimit të cilësisë dhe të sigurtë në punë”

Kërkesa për certifikime bazohet në standarde të njohura ndërkombëtare si ISO, OHSAS, EN etj, por gjithmone duke pranuar ekuivalentet

VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcakton se AK mund të kërkojë që prodhuesit ose operatorët ekonomikë të posedojnë certifikatat ISO për menaxhimin e cilësisë etj në përputhje me natyrën e furnizimit.

Certifikata ISO 45001:2018 (ose ekuivalent) është standart për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila siguron që prodhuesi ka implementuar masa parandalimi të aksidenteve, kontrollin e rrisqeve, dhe përmirësimin e kushteve të sigurisë gjatë procesit të prodhimit të pajisjeve. Si dhe ky standart është garanci për produkte të prodhuara sipas praktikave ndërkombëtare.

Certifikata ISO 9001:2015 ose ekuivalenete është standart nderkombetar për menaxhimin e cilësisë, i cili siguron se prodhuesi zbaton procese të kontrolluara për projektimin, prodhimin, testimin dhe shpërndarjen e pajisjeve

Te dyja certifikatat e kërkuara risin sigurinë e furnizimit me produkte të cilësisë së garantuar

Minimizojnë riskun teknik, siguron kontroll cilësie dhe është në përputhje me natyrën e kontratës.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 person me certifikatë nga prodhuesi për përdorimin dhe për trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve.

Argumentimi : Kjo kërkesë është bazuar mbështetur në 16/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku autoriteti kontraktor ka të drejtë të vendosë kritere që lidhen me kapacitetin teknik dhe profesional të operatoreve ekonomike. Gjithashtu VKM nr 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcakton se në dokumentat standarte të tenderit lejojnë që kriteret teknike/profesionale të përfshijë elemente që garantojnë cilësinë dhe sigurinë e funksionimit të produkteve /pajisjeve.

Për pajisjet teknike, komplekse, është praktikë nderkombetare që trajtimi, përdorimi dhe mirëmbajtja të kryhen nga persona të trajnuar posaçërisht.

Një person i certifikuar nga prodhuesi njihë mirë manualët dhe udhëzimet, si dhe përdorimin e tyre, si dhe të kryejë trajnimin e punonjësve që do të përdorin këto mjete.

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë transportin e mallrave pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor,

Argumentimi: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Kjo kërkesë është e arsyeshme dhe propoconale me objektin e kontratës, pasi garanton që mallrat të dorëzohen në mënyrë të sigurt në kohë dhe pa kosto shtesë për AK duke ruajtur integritetin dhe cilësinë e tyre deri në momentin e dorëzimit.

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë së mallit për 12 muaj nga momenti i dorëzimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe marrin përsipër periudhën e garancisë për

mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimi ose riparimi, mirëmbajtja dhe shërbimi pa pagesë.

2.2.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedat teknike, katalloget e pajisjeve të perkthyer dhe të noterizuara të cilat përmbajnë specifikimet teknike të pajisjeve të kërkuara.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacion teknik për secilin artikull të ofertuar në mënyrë që komisioni të vlerësojë në përputhje me specifikimet teknike. Perktimi dhe noterizimi janë kërkesa administrative standarte për dokumentat në gjuhë të huaj. Kjo kërkesë është thelbësore për verifikimin e përputhjes së ofertes me specifikimet teknike të kërkuara

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. Rul mbështetës për Tuba Ø 355 mm (14”IPS)

Gama e punës : -Ø 0 ÷ 355 mm; deri në 14”IPS

Permasat : -360 x 220x200 mm (14.1”x8.6” x7.9”)

Pesha : deri në 6Kg (13.2lb)

Shërben për mbështetjen e tubacioneve gjatë procesit të saldimit me makinat e saldimit me bashkim fund me fund. I projektuar për të minimizuar ferkimin dhe forcën tërheqëse të tubit, siguron levizje të lehta dhe të qëndrueshme të tubave, në kushte të vështira gjatë procesit të punës .

Permasat janë kërkuar duke marrë parasysh permasat e tubave që ne disponojmë.

2. Rul mbështetës vertikal për tuba Ø 355

Gama e punës : Ø 355 mm (14”IPS)

Permasat (GxTHxL) : 1421 x 600 x818 mm(55.9” x23.6”x32.2”)

Pesha : deri në 33 kg 72.8 lb

Kapaciteti mbajtës : 1000kg (2.200lb)

Sherben per mbeshtetjen e tubave gjate procesit te saldimit me makinat e saldimit me bashkim fund me fund. Rrotullat minimizojne ferkimin dhe forcen e terheqjes se tubave, ne kushte te veshtira gjate procesit te punes .

Permasat jane kerkuar duke mare parasysh permasat e tubave qe ne disponojme.

3.Prerese profesionale per tuba PE me mekanizem rrotllues

Prerese Tubash Ø180-Ø315

Gama e diamterave te tubave : Ø180÷315 mm (6”DIPS÷10”DIPS)

Trashesia maksimale e prerjes: Deri ne 19.4 mm

Permasat (Gjatesi x Gjeresi x Lartesi) : 670x880 x360 mm (26.4” x 34.6” x 14.2”)

Pesha : deri ne 7 kg (15.4lb)

Prerese Tubash Ø100-Ø160

Gama e diamterave te tubave : Ø100÷160 mm (3”DIPS÷5”IPS)

Trashesia maksimale e prerjes: Deri ne 17.5 mm

Permasat (Gjatesi x Gjeresi x Lartesi) : 372x465x200 mm (14.6” x 18.3” x 7.9”)

Pesha : deri ne 1.65 kg

Keto jane mjete profesionale , thelbesore per prerjen manuale te tubave plastike . Prereset jane cilesore me nivel te larte, duke i bere ato shume te manovrueshme dhe praktike per perdorimin ne terren. Ato mund te pajisen me tehe te vecanta me lartesi dhe kapacitete te ndryshme depretimi, te pershtatshme per prerjen e tubave nga materiale te ndryshme.

4.Scraper Tubash

Kompozimi standart i valixhes se pajisjeve

Scraper tubash

Teh rezerve

Celes manovrimi dore

Valixhe transporti prej alumini

Scraper Tubash Ø75-Ø315

Gama e punes : DJ Ø75÷315 mm(3"IPS ÷12"IPS), DJ:Ø58÷300mm(2.2"x11.8")

Gjatesia maksimale e pastrimit: 137 mm(5.4")

Permasat maksimale: 510x310x410mm (20"x12.2"x16.1")

Permasat e valixhes transportuese: 230x500x270mm (9"x19.7"x16.1")

Pesha e pajisjes: deri 4.5 kg (9.9 lb)

Pesha me perberje standarte 7.5 kg(16.5lb)

Keto pajisje profesionale jane te domosdoshme per pergatitjen e tubave plastike dhe lidhesve para saldimit me elektrofuzion. Praktike te lehta per perdorim , keto pajisje heqin shtresen e oksidimit te shkaktoar nga kushtet atmosferike dhe rrezet ultravjollce .Nese kjo shtrese nuk hiqet , ajo do te kompromentoje rende cilesine e lidhjes. Eshte nje pajisje qe mundeson mbajtjen e trashesise se cipit te vazhdueshem konstant , dhe nese tubi ka forme te deformuar , si dhe rregullimin e fjatesise se siperfaqes per pastrim ne varesi te thellesise se lidhesit elektrik.

5. Fiksues per pozicionimin preciz te tubave

Kompozimi standart

Fiksues komplet me kater kapes

Cante transporti ose valixhe druri per transport

Fiksuese tubash me dy akse Ø125-Ø500

Gama e punes : Ø125÷500mm ;4"IPS÷20"IPS

Permasat maksimale : Versioni me 2 aksi : 1815x610x410mm, Versioni me 3 aksi :1815x1230x410mm

Pesha : Versioni me 2 aksi :38 kg , Versioni me 3 aksi :52 kg

Kjo pajisje profesionale sherben per mbajtjen e tubave te palevizur dhe te perpajtuar gjate saldimit me elktrofuzion. Ka nje nyje qendrore per pozicionet fikse 45⁰ dhe 90⁰, kater kapes veteqendruese qe nuk kerkojne adaptues dhe nje bosht shtese se bashku me dy kapes per saldimitin e lidheseve "tee" . Kapeset me lirimin e shpejte mundesojne nxjerjen e shpejte te tubit pasi eshte salduar.

6.Pajisje per formesimin e skajve te tubave

Gama e punes: Ø40÷315 mm;1 ^{1/4}"IPS÷10"IPS

Materialet: HDPE,PB,PP,PVC,PVDF

Trashesia maksimale 35 mm (1.3")

Permasat: 128x235x310mm

Pesha : deri ne 1.50kg

Pajisjet jane profesionale per formesimin e skajeve te tubave plastike deri ne Ø315 mm (10"IPS), te destinuar per bashkime elektrofuzive dhe plug-in. Pajisjet jane bere nga materiale te ndryshme, perfshire plastike dhe aliazh special alumini. Forca speciale e thikave dhe mbulesa jo-ngjites (PTFE) e mureve lejojne formesim te shpejte dhe te lehte te skajeve te tubave .

7. Ekstruder per saldim plastik

Materialet : HDPE, PP

Tabak Plastike: 1.5÷20mm (1/16"-0.8")

Elektroda saldimi: Ø3-4mm (1/8"-5/32")

Prodhimi : deri ne 2.2kg/h (me HDPE, shkop Ø4mm/5/32")

Permasat: 450x310x100mm (17.7"x12.1"x3.9")

Furnizimi me energji: 230 V AC, 50/60Hz

Fuqia totale e konsumuar : 2700W

Pesha : deri ne 6.85kg (15.1lb)

Kjo pajisje eshte kerkuar per bashkimine tubave plastike duke i shkrirë dhe ngjitur strukturen e tyre ne menyre te kontrolluar ne zonen e bashkimit. Eshte e nevojshme pasi do tu vije ne ndihme punonjesve tane per riparimin e tubave plastike , ndertim pusetash ose struktura te tjera plastike.

Komisioni